

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
“PËR
MËNYRËN E PËRDORIMIT TË GJUHËS SË PAKICAVE
KOMBËTARE NË MARRËDHËNIET NDËRMJET PERSONAVE QË I
PËRKASIN PAKICAVE KOMBËTARE DHE ORGANEVE TË
VETËQEVERISJES VENDORE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore” ka si qëllim të sigurojë përdorimin e gjuhës së pakicës kombëtare të njohur formalisht me ligjin nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, në marrëdhëniet midis shtetasve që i përkasin pakicës dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore, krahas përdorimit të gjuhës shqipe.

Propozimi i këtij projektvendimi dhe më tej zbatimi i tij, lidhet me nevojat ekzistuese për kërkesë dhe akses në zonat gjeografike, ku ka banim domethënës ose tradicional të personave, që u përkasin pakicave kombëtare, duke marrë parasysh situatën specifike vendore. Nevoja e personave që u përkasin pakicave kombëtare, për përdorimin e gjuhës së pakicës, nuk nënkupton paaftësinë e këtyre personave të flasin gjuhën zyrtare të vendit tonë dhe varësinë e tyre tek shërbimet në gjuhën e pakicës, por ka si qëllim krijimin e mundësive për ruajtjen e gjuhës.

Gjuha e pakicës kombëtare do të përdoret në marrëdhëniet mes shtetasve që i përkasin pakicës dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore, në të cilat personat që i përkasin një pakice kombëtare banojnë tradicionalisht ose përbëjnë mbi 20 për qind të numrit të përgjithshëm të popullsisë brenda territorit të saj, bazuar në kërkesën me shkrim të tyre.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Brendshme, për vitin 2019, por është në

përputhje me politikat e qeverisë për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të pakicave kombëtare.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi i propozuar, është hartuar në zbatim të ligjit nr. 96/2017 dhe synon që njësitë e vetëqeverisjes vendore të krijojnë kushtet për përdorimin e gjuhës së pakicës në marrëdhëniet ndërmjet këtyre personave dhe bashkisë apo njësisë administrative përkatëse, duke parashikuar mënyrën e paraqitjes së kërkesës, procedurën e trajtimit të saj deri në marrjen e vendimeve nga organet përgjegjëse të vetëqeverisjes vendore, me qëllim zbatimin e të drejtës së tyre ligjore për të përdorur gjuhën e pakicës që i përkasin.

Gjuha e pakicës kombëtare do të përdoret në marrëdhëniet mes shtetasve që i përkasin pakicës dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore, në të cilat personat që i përkasin një pakice kombëtare banojnë tradicionalisht ose përbëjnë mbi 20 për qind të numrit të përgjithshëm të popullsisë brenda territorit të saj, bazuar në kërkesën me shkrim të tyre.

Rregullimi dhe garancitë që u sigurohen personave që i përkasin pakicës kombëtare, të përdorin gjuhën e pakicës në marrëdhëniet e tyre me njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas këtij projektakti, është një detyrim që buron dhe është në përputhje të plotë me Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, të ratifikuar me ligjin nr.8496, datë 3.6.1999, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe me ligjin për financat vendore.

Gjatë procesit të paraqitjes së kërkesës nga personat që i përkasin pakicës kombëtare, trajtimit të saj dhe vendimit në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, janë respektuar garancitë dhe të drejtat procedurale të personave që i përkasin pakicës kombëtare sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, është garantuar e drejta e ankimit kundër vendimit të refuzimit të kërkesës për përdorimin e gjuhës së pakicës, në marrëdhënie mes personave që i përkasin pakicave kombëtare, pranë gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.

Në projektvendim është parashikuar rregullimi i komunikimit të NJVV-ve me personat që i përkasin pakicës kombëtare, procese dhe të drejta të cilat janë parashikuar në përputhje me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Për të bërë të mundur përdorimin e gjuhës së personave që i përkasin pakicës kombëtare, organet përgjegjëse të njësisë të vetëqeverisjes vendore, parashikojnë në buxhetin vjetor të tyre, për aq sa është e mundur, zë të veçantë për punësimin të personave që njohin gjuhën e pakicës kombëtare, sipas

parashikimeve të ligjit për vetëqeverisjen vendore dhe ligjit për financat vendore.

E drejta ligjore e komunikimit në gjuhën e pakicës është propozuar të realizohet:

- gjatë procesit të informimit mbi të drejtat e tyre, duke hartuar për këtë qëllim rregullore apo nëpërmjet fletëve informuese, të cilat mund të publikohen/afishohen në ambiente të dukshme të organeve të vetëqeverisjes vendore;
- duke i siguruar akses në programin e transparencës;
- gjatë seancave të këshillimeve me bashkësinë përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, sipas parashikimeve të nenit 18, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përfaqësuesit e pakicave kombëtare apo me shoqatat që i përfaqësojnë këto komunitete;
- në paraqitjen e kërkesave apo ankesave drejtuar organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Gjithashtu, personave që i përkasin pakicës i garantohet e drejta për të paraqitur në gjuhën e tyre iniciativa qytetare nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, drejtuar këshillit bashkiak.

Emërtimi i njësisë administrative, rrugëve shesheve, territoreve, krahas gjuhës shqipe bëhet edhe në gjuhën e pakicës kombëtare, brenda territorit administrative të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në përputhje me parashikimet e ligjit nr 139/2015, pas paraqitjes së kërkesës, e cila i nënshtrohet të njëjtave rregulla si ato të parashikuara për kërkesën për përdorimin e gjuhës në komunikimin mes NJVV dhe këtyre personave, sipas këtij projektvendimi.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i propozuar për miratim është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe është hartuar në zbatim të nenit 100 të saj, si dhe të pikës 6, të nenit 15, të ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Projektvendimi i propozuar nuk bie ndesh me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Projektvendimi është në harmoni me Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës Për mbrojtjen e pakicave kombëtare, të ratifikuar me ligjin nr.8496, datë 3.6.1999.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk synon përafrim me *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi përbëhet nga 10 (dhjetë) pika.

Në pikën e parë është parashikuar se në njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, në të cilat personat që i përkasin një pakice kombëtare banojnë tradicionalisht ose përbëjnë mbi 20 për qind të numrit të përgjithshëm të popullsisë brenda territorit të saj, ato krijojnë kushtet për përdorimin e gjuhës së pakicës në marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe personave që i përkasin pakicës, bazuar në kërkesën e bërë prej tyre.

Në pikat 2, 3 dhe 4, është parashikuar forma e paraqitjes së kërkesës, autoriteti që i drejtohet, afati brenda të cilit duhet të shqyrtohet kërkesa, që është brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga paraqitja e saj pranë njësisë bazë të vetëqeverisjes vendore, organin që e shqyrton dhe që merr vendimin.

Kështu me paraqitjen e kërkesës, kryetari i bashkisë kërkon thirrjen e mbledhjes se këshillit bashkiak dhe merr masa për përgatitjen e materialeve për shqyrtim në mbledhje, bazuar mbi këtë kërkesë. Nëse vlerësohet e nevojshme për shqyrtimin e kërkesës, mund të zhvillohet një seancë dëgjimore me kërkuesit apo personin e autorizuar prej tyre. Kërkuesit njoftohen për mbledhjen e këshillit bashkiak në përputhje me parashikimet e nenit 17, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Në pikën pesë është parashikuar që vendimi i këshillit bashkiak pasi i nënshtrohet verifikimit të ligjshmërisë nga ana e prefektit të qarkut, i komunikohet personit të autorizuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Kodit të Procedurave Administrative. Kundër vendimit të refuzimit parashikohet e drejta e ankimit pranë gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.

Në pikën gjashtë është parashikuar përdorimi në gjuhën e pakicës, i cili realizohet si më në rastet e mëposhtme:

- a) gjatë procesit të informimit mbi të drejtat e tyre, në bazë të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, duke hartuar për këtë qëllim rregullore nga NJVV-të, apo nëpërmjet fletëve informuese, të cilat mund të publikohen/afishohen në ambiente të dukshme të organeve të vetëqeverisjes vendore;
- b) aksesit në programin e transparencës;

- c) gjatë seancave të këshillimeve me bashkësinë përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, sipas parashikimeve të nenit 18, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përfaqësuesit e pakicave kombëtare apo me shoqatat që i përfaqësojnë këto komunitete;
- d) në paraqitjen e kërkesave apo ankesave drejtuar organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- e) për të paraqitur iniciativa qytetare nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, drejtuar këshillit bashkiak sipas parashikimeve të përcaktuara në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këshillit bashkiak, në përputhje me nenin 20, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Në pikën shtatë, është parashikuar se për të siguruar komunikimin në gjuhën e pakicës në rastet e specifikuara në pikën 6, të këtij projektvendimi, organet përgjegjëse të njësive të vetëqeverisjes vendore, mund të parashikojnë në buxhetin vjetor të tyre, për aq sa është e mundur, zë të veçantë për punësimin e personave që njohin gjuhën e pakicës kombëtare, sipas parashikimeve të ligjit për vetëqeverisjen vendore dhe ligjit për financat vendore.

Kjo dispozitë nuk cenon autonominë e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, pasi përdorimi i gjuhës së pakicës është detyrim në zbatim të ligjit nr. 96/2017 dhe ky projektvendim synon vetëm të përcaktojë rregullat dhe procedurat për të garantuar këtë të drejtë.

Në pikën tetë është parashikuar se në rastet kur ka një kërkesë të mjaftueshme nga persona, që i përkasin një pakice kombëtare, pranë organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore, me një popullsi ku mbi 20 për qind e banorëve i përkasin pakicës, këshilli bashkiak, në përputhje me shkronjën “II”, të nenit 54, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, vendos për emërtimin e njësisë administrative, rrugëve shesheve, territoreve, krahas gjuhës shqipe edhe në gjuhën e pakicës kombëtare. Në këtë rast, kërkesa paraqitet dhe shqyrtohet nga organet përgjegjëse të njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas parashikimit të bërë në pikat 2-5, të këtij vendimi.

Në pikën nëntë është parashikuar që efektet financiare për tabelat për emërtimin e njësisë administrative, rrugëve shesheve, territoreve, në gjuhën e pakicës kombëtare, brenda territorit administrative të njësisë, sipas pikës 8, të këtij vendimi, përballohen nga buxheti i njësive përkatëse të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me nenin 28, të ligjit nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar.

Në pikën e dhjetë, të projektvendimit është përcaktuar si institucion përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi, Ministria e Brendshme dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi janë Ministria e Brendshme dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Brendshme dhe i është dërguar për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Projektvendimi është ripunuar tërësisht në reflektim të sugjerimeve të dhëna nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë është shprehur dakord, por nisur nga fakti që projektvendimi është ripunuar, do të dërgohet për mendim përsëri në këtë ministri.

Projektvendimi pasi është dërguar për bashkërendim ka marrë dakordësinë e plotë nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është shprehur parimisht dakord me disa sugjerime të cilat janë reflektuar, konkretisht:

Sugjerimi i parë, për parashikimin që kërkesa me shkrim të debozitet nga jo më pak se një për qind të banorëve të bashkisë, në territorin e së cilës banojnë personat që i përkasin një pakice kombëtare është reflektuar tërësisht.

Sugjerimi i dytë për të evidentuar se cila njësi e vetëqeverisjes vendore, i drejtohet kërkesa, është reflektuar duke parashikuar “njësinë bazë të vetëqeverisjes vendore” e cila është bashkia.

Në lidhje me sugjerimin e pikës 2 për të zëvendësuar termin “këta persona” me togefjalëshin “personat që i përkasin një pakice kombëtare”, për të shmangur abuzimin në interpretime, sqarojmë se: pika 2 lexohet në terësinë e saj pa ndarje fjalësh, theksojmë se është e qartë dhe nuk vlerësohet e nevojshme për ta ndryshuar kjo sepse përsëritja shumë herë e të njëjtit fakt në një pikë, nuk do të sjellë ndonjë vlerë të shtuar .

Sugjerimi për të ndryshuar termin “komunikim” në “përdorim” është reflektuar.

Sugjerimi i pikës 6 të projektvendimit, për ndryshimin e togfjalëshit “iniciativa qytetare” nuk është reflektuar pasi është në përputhje me nenin 20 të ligjit “Për vetëqeverisjes vendore”. Gjithashtu, sugjerimi për të shtuar “konsultimin publik në procesin e vendimarrjes” nuk është reflektuar pasi konsiderohet e pa nevojshme të përsëritet i njëjtin parashikim me nenin 15,16 të ligjit 139/2015, ku sanksionohet se është e detyrueshme nga ana e organeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore të garantojnë pjesëmarrjen publike dhe të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik.

Në lidhje me sugjerimin 7, theksojmë se parashikimi në buxhetin e njësive, për një zë të veçantë, aq sa është e mundur, sanksionohet sepse, sistemi buxhetor dhe i financave vendore varet nga instrumentat e atribuara nga pushteti qendror si dhe mjaftueshmërisë dhe stabilitetit të burimeve financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore. Parashikimi për një zë të veçantë në buxhetin vjetor të njësive realizohet vetëm për punësimin e personave duke u bazuar në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe ligjit nr. 34/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Në lidhje me sugjerimin për të parashikuar të njëjtën procedurë të kërkesës për emërtimin e njësisë administrative, rrugëve, shesheve, territoreve, krahas gjuhës shqipe edhe gjuhën e pakicës kombëtare si në pikën 2, është reflektuar.

Projektvendimi është ripunuar në bazë të sugjerimeve të dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe nisur nga ky fakt do të ridërgohet për bashkërendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Detyrimet financiare të përcaktuara në këtë projektvendim, në veçanti efektet financiare për tabelat për emërtimin e njësisë administrative, rrugëve shesheve, territoreve, në gjuhën e pakicës kombëtare, sipas këtij projektvendimi, përballohen nga buxheti i njësive përkatëse të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me nenin 28, të ligjit nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar, dhe është kompetencë e NJVV-ve, por edhe si detyrim i përcaktuar në pikën 3, të nenit 15, të ligjit nr. 96/2017, ku përcaktohet se:

“Me vendim të organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore, ku mbi 20 për qind e banorëve u përkasin pakicave kombëtare, kur ka një kërkesë të mjaftueshme prej tyre, emërtimet e njësive administrative përkatëse, të rrugëve dhe të treguesve të tjerë topografikë, krahas gjuhës shqipe shfaqen dhe në gjuhën e pakicës përkatëse, sipas parashikimeve ligjore për vetëqeverisjen vendore”.

Në nenin 54, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, në shkronjë “ll”, përcaktohet se:

“Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

...

ll) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë;”, pra është një kompetencë e vetë e bashkisë dhe jo e deleguar.”

Ndërsa në lidhje me efektet financiare që mund të burojnë për bashkitë në zbatim të pikës shtatë, të këtij projektvendimi, theksojmë se përdorimi i gjuhës së pakicës në marrëdhënie me bashkitë është detyrim i përcaktuar në ligjin nr.96/2017. Ky projektvendim vetëm përcakton rregullat dhe procedurat për ta bërë të mundur zbatimin e këtij detyrimi ligjor, kjo në varësi edhe të mundësive buxhetore të bashkive, ndërkohë që planifikimi buxhetor nga ana e tyre do të bëhet brenda mundësive dhe vetëm në ato bashki që do të kenë persona që i përkasin pakicave sipas përqindjes së përcaktuar në ligj dhe që paraqesin kërkesë sipas këtij projektvendimi.

PROPOZUESI

MINISTRI

SANDËR LLESHAJ

Znj. Romina KUKO, Zëvendësministër i Brendshëm.

Z. Plarent NDRECA, Sekretar i Përgjithshëm.

Znj. Silvana BANUSHI, Drejtor i Përgjithshëm Rregullator dhe Përputhshmërisë për Rendin dhe Sigurinë Publike.

Z. Bledar DORACAJ, Drejtor i Përgjithshëm i Gjendjes Civile

Znj. Dorela KARARAJ, Specialiste e Sektorit të Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore.